



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0596

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-kryetar, Kimete Gashi dhe Vedat Poterqoi-anetarë, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) OLTİ SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit të Komuna Prishtinë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Liceut Artistik-Ndërtesa kryesore" me numër të prokurimit; 616-25-4150-5-1-1, me 28.08.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa OE "OLTİ" SH.P.K., me nr. 2025/0596, e datës 03/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Liceut Artistik-Ndërtesa kryesore" me numër të prokurimit; 616-25-4150-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.
2. Të korigjohet, Dosja Tenderit/ Njoftimi për Kontratë, për prokurimin e titull "Ndërtimi i Liceut Artistik-Ndërtesa kryesore". Autoriteti kontraktues, të bëjë përmirësimet në Dosje të Tenderit/Njoftimit për Kontratë, sipas konstatimeve të raportit të ekspertit shqyrtues me rekomandim, të mbështetura nga Paneli shqyrtues dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas ligjit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Megjense ankesa aprovohet si e bazuar e OE "OLTİ" SH.P.K., konform nenit 31 parag. 4 i kthehet tarifa e sigurimit ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, ndërsa sipas nenit 31.parag.6 të Rregullores së Punës së OSHP, OE ankues obligohet të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.05.2025, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ndërtimi i Liceut Artistik-Ndërtesa kryesore me numër të prokurimit 616-25-4150-5-1-1.

Autoriteti Kontraktues në këtë rast ka zhvilluar procedurë të hapur të prokurimit lloji i kontratës Pune , vlera e parashikuar e kontratës: 8,500,000.00 €

Me 24.06.2025, OE OLTİ SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 26.06.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.07.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE OLTİ SH.P.K., me nr. 2025/0596, lidhur me aktivitetin Ndërtimi i Liceut Artistik-Ndërtesa kryesore me numër të prokurimit 616-25-4150-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OLTİ SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

"Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, sepse ka dështuar të sigurojë një proces transparent, të drejtë dhe konkurrues duke vendosur kriterë të paarsyeshme dhe duke favorizuar operatorë të caktuar. Shkelja e nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik

Ky nen përcakton se autoritetet kontraktuese duhet të sigurojnë:

- Trajtim të barabartë,

- Mosdiskriminim,

- Proporcionalitet,
- Konkurrencë të lirë dhe efektive.

Kriteri për përvojë vetëm në shkolla/qerdhe përjashton padrejtësisht OE-të që kanë realizuar projekte të ngjashme ndërtimore me kompleksitet të barabartë, duke kufizuar konkurrencën dhe duke diskriminuar operatorët.

Në përputhje me parimet e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, veçanërisht me Nenin 7 që kërkon proporcionalitet dhe barazi në kriteret e përvojës, kërkojmë që të pranojë si referencë të vlefshme edhe punët ndërtimore të ngjashme me kompleksitet të barabartë, siç janë ndërtesat banimi, zyra dhe ndërtesa komerciale.

Kufizimi i përvojës vetëm në projekte shkollore dhe çerdhe është i padrejtë dhe i paarsyeshëm, dhe në mënyrë të padrejtë përjashton operatorët ekonomikë me kapacitete të provuara në fusha të ngjashme ndërtimore.

Shkelja e nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik

Sipas këtij neni, specifikimet teknike nuk duhet të krijojnë pengesa të panevojshme për konkurrencë. Kërkesa për pajisje që nuk lidhen me natyrën reale të kontratës (si aparati për testim EN 805/W400, makina për tharje druri, etj.) janë të pajustificuara dhe diskriminuese.

Shtimi i kriterëve kufizues jashtë afatit ligjor për sqarime: Autoriteti kontraktues ka publikuar/dorëzuar ndryshime të dokumenteve të tenderit duke shtuar kriterë të reja në lidhje me:

- o Kërkimin e autorizimit nga prodhuesi apo dileri i autorizuar (neni 23 i shtuar FTD),
- o Kërkimin e dorëzimit të katalogëve zyrtarë të prodhuesit (neni 24 i shtuar FTD).

Këto shtesa janë bërë pas skadimit të afatit për sqarime shtesë dhe në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 27 të Rregullave të Prokurimit Publik (RRPP), i cili përcakton se pas datës së fundit për sqarime nuk mund të ndryshohen dokumentet bazike të tenderit në dëm të operatorëve ekonomik.

Kriteret e shtuara pas fazes së sqarimit të tenderve janë diskriminuese dhe kufizuese:

- Kërkesa për autorizim nga prodhuesi me shënim të numrit të prokurimit dhe titullit të aktivitetit favorizon operatorë të caktuar që i kanë këto autorizime të gatshme dhe është afatit shumë i shkurter që OE të paisen me këto autorizime.
- Kërkesa për katalogë zyrtarë për secilën pajisje teknike është e tepruar, jo proporcionale dhe duke qenë e favorizuese dhe e kordinuar me OE të caktuar. Tendencë e qartë për favorizim: Këto kushte specifike, të futura në minutën e fundit dhe pas afateve ligjore, i përshaten vetëm kompanive që kanë bashkëpunim të drejtpërdrejt me Autoritetin Kontraktues ose që janë në dijeni paraprake për tenderin.

Kjo përben favorizim të qartë të OE-ve të caktuar, duke cenuar parimin e konkurrencës së lirë dhe qasjes së barabartë.

Aparati për testimin e gypave EN 805/W400

Kërkesa që operatori ekonomik të posedojë këtë aparat është e panevojshme dhe jopraktike, pasi kompania që monton gypat nuk ka sens të kryejë testimin e tyre teknikisht dhe ligjërisht. Gypat duhet të testohen nga një laborator i licencuar dhe i pavarur për testimin e gypave, i cili do të lëshojë certifikatë zyrtare për cilësinë dhe sigurinë e punës.

Për këtë arsye, kërkesa duhet të jetë që operatori të paraqesë certifikatën nga laborator i licencuar pas përfundimit të montimit, jo posedimi i aparatit testues.

- Makine mekanike për drejtimin e teheve të sharrës
- Makine e zdrukthimit, petëzimit ose të gdhenjës formë nga prerja
- Furrë industriale për tharjen e lëndës drusore

Këto pajisje janë pjesë e linjës së prodhimit të produkteve drusore dhe nuk mund të kërkohen veçmas. Një kërkesë e tillë përveçse është e paarsyeshme, kufizon operatorët ekonomikë, sepse këto makina nuk mund të ndahen dhe kërkohet komplet linja e prodhimit nëse kërkohen. Gjithashtu, produktet druri vijnë të përfunduara nga prodhuesit dhe nuk ka nevojë që operatori të posedojë këto pajisje specifike në vendin e realizimit të kontratës. Kjo krijon dyshime për favorizim të operatorëve ekonomikë të caktuar dhe cenon parimin e konkurrencës së lirë.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: Operatori ekonomik "OLTI" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 24.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik - Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (znieritum) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Kërkesa për posedimin e pajisjeve specifike në Aneksin nr. 7 të dosjes së tenderit, konkretisht:

Aparat për testimin e gypave EN 805/W400

Makinë mekanike për drejtimin e teheve të sharrës

Makinë e zdrukthimit, petëzimit ose të gdhendjes me prerje

Furrë industriale për tharjen e lëndës drusore

Përbën kufizim të pajustificuar dhe të panevojshëm për realizimin e kontratës.

Aparat për testimin e gypave EN 805/W400

Mendojmë se është kërkesë e panevojshme sepse aparati për testimin e gypave nuk ka sens që kompania e cila i monton gypat edhe t'i testojë, prandaj gypat mund të testohen nga një laborator i licencuar për testimin e gypave. Prandaj mendojmë që kërkesa duhet të jetë që pas montimit të prezantohet certifikata nga laborator i për testimin e gypave.

Makinë mekanike për drejtimin e teheve të sharrës

Makinë e zdrukthimit, petëzimit ose të gdhendjes formë nga prerja

Furrë industriale për tharjen e lëndës drusore

Këto janë pjesë e linjës së prodhimit dhe këtu hyjnë krejt pajisjet dhe nuk mund të kërkohen makina ndaras nga linja e prodhimit sepse nuk mund të ndahen ose duhet të kërkohet komplet linja e prodhimit. Gjithashtu duhet të cekim se produktet e drurit vijnë të gatshme dhe nuk ka nevojë për këto pajisje sepse këto pajisje janë të rralla dhe kemi dyshime se po favorizohen kompani të caktuara.

Këto pajisje nuk janë të domosdoshme për realizimin e kontratës sipas përshkrimit të punëve në dokumentet e tenderit. Kërkesa për to është teknike, e specializuar dhe cenon konkurrencën e lirë në tender.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se pajisjet të cilat kërkon parashtruesi që të largohen janë pajisje absolutisht të domosdoshme për realizimin me sukses të projektit. Në anën tjetër as vetë parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë kundërgargument sipas të cilit do të mund të konfirmohet e kundërta.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 08.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0596/2025, ndërsa me datë 23.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues/teknik me nr. 2025/0596 me rekomandimet si në vijim: Duke u

bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, “Autoriteti kontraktues nuk është përgjegjës rreth raportit të ekspertit shqyrtues po ashtu as OE nuk është përgjegjës rreth raportit të ekspertit shqyrtues,

Lidhur me pretendimet e OE OLT SH.P.K., ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0596 ka vlerësuar si në vijim:

Duke u mbështetur në ekzaminimin e lëndës, konstatojmë si në vijimë:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1.

OE “Olti shpk –Prishtinë, pretendon se A.K., Kuvendi i Komonës së Prishtinës , nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër tjera qëllim i këtij neni është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese që të sigurojnë menyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen , procedurat që do të ndiqen ,te drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen,si dhe të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik.

AK e ka trajtuar kërkesën për rishyrtim të OE ankues si të pa bazuar,me arsyen se specifikat dhe kriteret e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ,nuk janë në kundërshtim me dispozitat e theksuara më lart ,gjithashtu në vendimin e dt.26.06.2025 me të cilin është shqyrtuar kërkesa për ri-shqyrtim AK ndër tjera thekson zyrtari përgjegjës i prokurimit ja ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kerkuese .

OE pretendon se disa specifika dhe kriteret të parapara me NJK dhe DT janë në kundërshtim me dispozitat e përmendura ma lart.

Ekspertja është e mendimit se qëndron pretendimi i OE ankues sepse disa specifika dhe kriteret të vendosura në DT është e nevojshme të modifikohen me qëllim që të krijohet mundësia e zgjerimit të konkurrencës pa e cenuar apo më drejtë të themi pa e dëmtuar aktivitetin e prokurimit,ndërsa arsyen ma të detajuar do ta gjeni më poshtë .

Andaj ,

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2.

OE “Olti shpk –Prishtinë, pretendon se A.K., Kuvendi i Komonës së Prishtinës , nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së .

Ekspertja sqaron se ndër të tjera qëllimi i nenit 6 të LPP-së është të udhëzohen autoritetet kontraktuese të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, fondet

publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

AK e ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues si të pa bazuar, me arsyen se specifikat dhe kriteret e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, nuk janë në kundërshtim me dispozitat e theksuara më lart.

OE pretendon se disa nga specifikat dhe kriteret e parapara me NJK dhe DT janë në kundërshtim me dispozitat e përmendura më lart.

Ekspertja edhe për këtë dispozitë është e mendimit se specifikat dhe kriteret të vendosura nuk janë në harmoni me qëllimin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa arsyen më të detajuar do ta gjeni më poshtë.

Ekspertja sqaron se ky pretendim është i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3.

OE "Olti shpk – Prishtinë, pretendon se A.K., Kuvendi i Komonës së Prishtinës, nuk e ka respektuar nenin 7 nën 28 të LPP-së, si dhe n 27 të Rregullave të Prokurimit Publik (RRPP),

Ekspertja thekson se ndër të tjera qëllim i nenit 7 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet të trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Ekspertja thekson se qëllim i nenit 28 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues

është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik, që nënkupton se specifikat teknike janë kërkesa obligative për të gjithë tenderuesit.

Ekspertja sqaron se ndër të tjera qëllim i nenit 27 të RRPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i shihet domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve.

Pretendimi i OE ankues: Kriteri për përvojë vetëm në shkollë/qerdhe përjashton padrejtësisht OE-të që kanë

realizuar projekte të ngjashme ndërtimore me kompleksitet të barabartë, duke kufizuar konkurrencën dhe duke diskriminuar operatorët.

Në përputhje me parimet e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, veçanërisht me Nenin 7 që kërkon proporcionalitet dhe barazi në kriteret e përvojës, kërkojmë që të pranojë si referencë të

vlefshme edhe punët ndërtimore të ngjashme me kompleksitet të barabartë, siç janë ndërtesat banimi, zyra dhe ndërtesa komerciale.

Kufizimi i përvojës vetëm në projekte shkollore dhe çerdhe është i padrejtë dhe i paarsyeshëm, dhe në mënyrë të padrejtë përjashton operatorët ekonomikë me kapacitete të provuara në fusha të ngjashme ndërtimore.

Ekspertja sqaron se qendron pretendimi i OE ankues sepse perveq punëve të përmendura në kriter ka edhe punë të tjera të ngjashme që janë të barasvlefshme apo edhe më komplekse se sa ky aktivitet i prokurimit andaj konsideroj se qendron pretendimi i OE ankues .

Pretendimi i OE ankues,

Shtimi i kriterëve kufizues jashtë afatit ligjor për sqarime: Autoriteti kontraktues ka publikuar/dorëzuar ndryshime të dokumenteve të tenderit duke shtuar kriterë të reja në lidhje me:

- o Kërkimin e autorizimit nga prodhuesi apo dileri i autorizuar (neni 23 i shtuar FTD),

- o Kërkimin e dorëzimit të katalogëve zyrtarë të prodhuesit (neni 24 i shtuar FTD).

Këto shtesa janë bërë pas skadimit të afatit për sqarime shtesë dhe në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 27 të Rregullave të Prokurimit Publik (RRPP), i cili përcakton se pas datës së fundit për sqarime nuk mund të ndryshohen dokumentet bazike të tenderit në dëm të operatorëve ekonomik.

Kriteret e shtuara pas fazës së sqarimit të tenderëve janë diskriminuese dhe kufizuese:

- Kërkesa për autorizim nga prodhuesi me shënim të numrit të prokurimit dhe titullit të aktivitetit favorizon operatorë të caktuar që i kanë këto autorizime të gatshme dhe është afatit shumë i shkurter që OE të paisen me këto autorizime.

- Kërkesa për katalogë zyrtarë për secilën pajisje teknike është e tepruar, jo proporcionale dhe duke qenë favorizuese dhe e kordinuar me OE të caktuar.

Ekspertja sqaron se qendron pjesërisht pretendimi i OE ankues sepse AK ka shtuar kriterë në DT siq janë përmendur nga OE ankues shtimi i kriterëve në DT nënkupton ndryshim i DT ,ndërsa AK siq parashihet me nenin 24.7 të RRPP-së në fuqi duke plotësuar formularin B54 dhe Modifikuar DT dhe duke e shtyrë afatin e hapjes sikurse parashihet me këtë dispozitë ,mirëpo AK meqë ka shtuar kriterë do duhej të shtynte edhe afatin për sqarime e të njëjtin nuk e ka shtyrë pra nuk ka dhënë afatë shtesë për sqarime por vetëm për dorëzimin e ofertave siq njihet afati i hapjes ,ndërsa sa i përket pretendimit për shtimin e kriterëve ky pretendim nuk qendron sepse autorizimet dhe katalogët nuk janë kriterë diskriminues.

Andaj si pretendim i OE ankues është i bazuar .

Pretendimi i OE ankues

Aparati për testimin e gypave EN 805/W400

Kërkesa që operatori ekonomik të posedojë këtë aparat është e panevojshme dhe

jopraktike, pasi kompania që monton gypat nuk ka sens të kryejë testimin e tyre teknikisht

dhe ligjërisht. Gypat duhet të testohen nga një laborator i licencuar dhe i pavarur për testimin e gypave, i cili do të lëshojë certifikatë zyrtare për cilësinë dhe sigurinë e punës. Për këtë arsye, kërkesa duhet të jetë që operatori të paraqesë certifikatën nga laborator i licencuar pas përfundimit të montimit, jo posedimi i aparatit testues.

Ekspertja sqaron se nuk qendron pretendimi i OE ankues sepse kjo pajisje është paraparë në aneksin 7 të DT dhe për këtë pajisje është dhënë edhe mundësia e marrjes me qera dhe pajisjet për testim janë të parapara edhe me UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 3.7 përkatsisht në menyrë tabelare është përcaktuar në piken (u) çdo inspektim ose teste që kërkohen, dhe metodat e testimit

E njëjta është e lejuar siq u përmend më lart dhe përveq asaj është dhënë edhe mundësia e marrjes me qera për OE që nuk e posedojnë.

Andaj si pretendim është i pa bazuar .

Pretendimi i OE ankues

- Makine mekanike për drejtimin e teheve të sharrës
- Makine e zdrukthimit, petëzimit ose të gdhenjës formë nga prerja
- Furrë industriale për tharjen e lëndës drusore

Këto pajisje janë pjesë e linjës së prodhimit të produkteve drusore dhe nuk mund të kërkohen veçmas. Një kërkesë e tillë përveçse është e paarsyeshme, kufizon operatorët ekonomikë, sepse këto makina nuk mund të ndahen dhe kërkohet komplet linja e prodhimit nëse kërkohen. Gjithashtu, produktet druri vijnë të përfunduara nga prodhuesit dhe nuk ka nevojë që operatori të posedojë këto pajisje specifike në vendin e realizimit të kontratës. Kjo krijon dyshime për favorizim të operatorëve ekonomikë të caktuar dhe cenon parimin e konkurrencës së lirë.

Ekspertja sqaron se qendron pretendimi i OE ankues sepse produktet druri vijnë të përfunduara nga prodhuesit dhe nuk ka nevojë që operatori të posedojë këto pajisje ,sepse nuk është relevante për AK vendi i përpunimit,konsideroj se e kufizojnë konkurrencën dhe njëkohësisht ndikojnë edhe në çmim ,sepse ofertues për ndërtim ka në treg të shumtë e të specializuar por specifikat e përmendura më lart e që janë kontestuar nga OE ankues nuk janë të nevojshme për këtë aktivitet të prokurimit e që nuk janë në harmoni me qëllimin e nenit 28 të LPP-së .

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "OLTI" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes Dosjes së tenderit/Njoftimit për kontratë, ku Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "OLTI" SH.P.K, janë të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik me rastin e hartimit të kërkesave Dosjes së Tenderit/Njoftimit për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Liceut Artistik-Ndërtesa kryesore" me numër të prokurimit; 616-25-4150-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit ekonomik OE "OLTI" SH.P.K. aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me Dosjen e Tenderit/Njoftimi për kontratë, obligohet Autoriteti kontraktues, të bëjë përmirësimet në Dosje të Tenderit-Njoftimit

për Kontratë në harmoni me nenin 53 të LPP-se, sipas vlersimeve/përgjigjeve në pretendimet ankimore si të bazuara dhe pjesërisht të bazuara, nga Raporti ekspertit shqyrtues, të mbështetura nga Paneli shqyrtues dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Paneli shqyrtues konsideron se ankesa është e bazuar pjesërisht, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK lidhur me atë nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenet 7, 27, 69 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE "OLTI" SH.P.K, vendosi t,i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues me rastin e parashtrimit të ankesës, bazuar në nenin 31 par. 4 dhe par.6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - OLTİ SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: